



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 143, Datë 25.06.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“ALESIO-2014” SH.P.K PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “FUSHË-ARRËZ”, ME FUQI TË  
INSTALUAR 1990 KW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1, gërma “a”, të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ALESIO-2014” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “FUSHË ARRËZ”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALESIO 2014” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 420 Prot., datë 28.05.2018, ka paraqitur kërkesë për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “FUSHË ARRËZ”.
- Aplikimi i shoqërisë “ALESIO-2014” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:

➤ Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gërmat “a”, “c”, “d”; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9 pika 2, gërma “d” (vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata);
- Nenin 9, pika 3 gërmat “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe sigurimeve shoqërore) dhe “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);
- Nenin 9 pika 4.1.3, gërma “b”, (Një diagramë elektrike në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, t’i paraqesë në ERE, brënda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ALESIO-2014“ sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Fushë-Arrëz”, me fuqi të instaluar 1990 kW.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.